



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:005744
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571990

C.nr.2306/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit B.T., nga Komuna e Gjakovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Guta, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Drejtoria e Arsimit – Komuna e Gjakovës, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 97.67 Euro, jashtë seance me datë 15 prill 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.T. nga Komuna e Gjakovës, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të lartcekur, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga 01.09.2022 e deri me datë 21.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 97.67€ (nëntëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 11.12.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 228.00.-€ (dyqind e njëzet e tetë euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi B.T., nga Komuna e Gjakovës në këtë gjykatë me datë 11.12.2023, përmes të autorizuarit të tij Arbër Guta, avokat në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës i lëndëve ekonomike në SH.M.L “... “Komuna Gjakovë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëses. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësja ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar që të i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë nga data 01.09.2022 e deri me datë 21.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 97.67€, e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 30.01.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, duke mos e kontestuar faktin që paditësja është në marrëdhënie pune te paditësja, mirëpo ky kompensim paditëses nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ndër të tjera ka shtuar se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit KKA është në kundërshtim me ligjin e punës, dhe kjo kontratë nuk është e bazuar në ligj, si dhe është në kundërshtim me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës, si me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësit nr.03/L-048 me plotësim ndryshimet e tij(më tutje si në përgjigje ne padi). Ka propozuar kërkesë padia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizimit të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës

– Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, si mësimdhënës i lëndëve ekonomike në shkollën “....”. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes zingjyrore të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen për vitin 2022 (brenda kërkesës së paditësit) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën Shtator - Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 459.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 2 mujore në total të jetë 97.67 euro, apo 48.83 euro për muaj ($459 * 11.6\% * 2 = 97.67$).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës, nga data 01.09.2022 fillimisht si zëvendësim për pushim të lehonisë, pastaj me kontratë për kohë të pa caktuar, dhe në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen. Kurse, pretendimet e tjera të paditurës gjykata i vlerësoj si pa bazë për vendosje ndryshe.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

E për më tepër, gjykata përlogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2022 (sipas kërkesës së paditëses), andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç ‘rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, dhe përpilimin e parashtrësës shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2024:005744, datë 15 prill 2024

Gj y q t a r j a,
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatë